



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 128, datë 13.2.2020

PËR

**PËRCAKTIMIN E VLERËS SË DËMIT TË SHKAKTUAR NË ZONAT
E MBROJTURA MJEDISORE, MËNYRËN E VLERËSIMIT,
MBLEDHJES DHE ADMINISTRIMIT TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 68, të ligjit nr.81/2017, "Për zonat e mbrojtura", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore, e cila përbëhet nga dëmi i shkaktuar dhe kostot e riparimit të dëmit, e të rehabilitimit të zonës e të kthimit të saj në gjendjen e mëparshme si dhe administrimin e vlerës monetare të zhdëmtimit nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), e cila, nëpërmjet strukturave të saj të varësisë, Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM), në nivel qarku, vendos masat administrative dhe mbledhjen e vlerës për dëmin e shkaktuar në zonë të mbrojtur mjedisore (ZMM).
2. Personi juridik ose fizik, publik ose privat, vendas a i huaj, është përgjegjës për të paguar:
 - a) vlerën e dëmit të shkaktuar;
 - b) koston e riparimit të dëmit, me qëllim rehabilitimin dhe kthimin në gjendjen e mëparshme të sipërfaqes së ZMM-së.
3. Vlera e dëmit të shkaktuar në sipërfaqet e zonave të mbrojtura, që paguajnë dëmtuesit e zonës së mbrojtur, është sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi bëhet me metoda standarde të matjes së sasisë apo sipërfaqes së dëmtuar, duke u bazuar për këtë në moshën (e fidanëve, drurëve pyjorë etj.), kohën e shpenzuar apo madhësinë e njësisë, sipas rastit të paraqitur për secilin zë në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kostot e riparimit të dëmit e të rehabilitimit të zonave të dëmtuara për kthimin e saj në gjendjen e mëparshme, përcaktohen rast pas rasti me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së.
5. Kontrolli i zonës së mbrojtur, me qëllim vlerësimin e dëmit, realizohet nga administrata e zonës së mbrojtur dhe bëhet rast pas rasti, nga struktura e AdZM-ve në qarqe, ose me grupe të posaçme, me përbërje të punonjësve të AdZM-së dhe të ekspertëve mjedisorë, në rast se lind e nevojshme, dhe që ngrihen me urdhër të drejtorit të AdZM-së, në të cilin përcaktohet objekti i kontrollit dhe koha e kryerjes së tij.
6. Strukturat përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit, të përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, zbatojnë procedurat e parashikuara në ligjin nr.10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
7. Procesverbali i dëmit, sipas formatit të miratuar me urdhër të ministrit, firmoset nga të dyja palët. Mosfirmosja e tij nga personi juridik ose fizik, publik ose privat, vendas a i huaj, ose nga përfaqësuesi i tij, nuk e bën atë të pavlefshëm.
8. Struktura përgjegjëse në AdZM, për ushtrimin e kontrollit, pas konstatimit të shkeljeve, brenda 5 (pesë) ditëve, së bashku me një kopje të procesverbalit, i paraqet komisionit të AKZM-së një raport, i cili përmban informacion mbi shkeljet e konstatuara, duke përmbledhur arsyet ligjore dhe faktike për të cilat kërkohet vendimmarrja e AKZM-së. Ndaj vendimit të Komisionit të AKZM-së, personi juridik ose fizik, publik ose privat, vendas a i huaj, mund të ushtrojë të drejtën e ankimit te drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së.
9. Në rastet e ankimit, drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së krijon grupin e ekspertëve të rivlerësimit, të përbërë nga specialistët e AKZM-së dhe, sipas rastit, mund të thërrasë edhe ekspertë të tjerë të fushës, të cilët, së bashku me specialistët e AdZM-së dhe personin juridik ose fizik, publik ose privat, vendas a të huaj, kryejnë rivlerësimin e dëmit, për të cilin mbahet një proceverbali rivlerësimi.
10. AKZM-ja, pas marrjes së raportit të rivlerësimit të dëmit, përcakton datën për shqyrtimin e pretendimeve të personit juridik ose fizik, publik ose privat, vendas a të huaj, e cila iu njoftohet atyre zyrtarisht, me qëllim paraqitjen e provave mbi pretendimet e ngritura.
11. AKZM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve, njofton me shkrim personin juridik ose fizik, publik ose privat, vendas a i huaj, për vendimin e marrë. Në rastet e mospranimit ndaj vendimit të dhënë, bazuar në dispozitat ligjore dhe në aktet

nënligjore në fuqi, bëhet ankim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

12. Të ardhurat e siguruara nga mbledhja e vlerës së dëmit, e shkaktuar në zonë të mbrojtur mjedisore, administrohet në llogarinë e të ardhurave të AKZM-së dhe përdoren në përputhje me nenin 58, të ligjit nr.81/2017, “Për zonat e mbrojtura”.
13. AKZM-ja është përgjegjëse për përdorimin e të gjitha të ardhurave të realizuara në territorin e zonave të mbrojtura mjedisore nga aktiviteti ekonomik, përfshirë edhe pagesat e vlerës së dëmit, sipas ligjit nr.81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, në përputhje edhe me dispozitat e akteve të tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi.
14. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I TURIZMIT
DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



VLERA E DËMIT QË PAGUAJNË DËMTUESIT NË ZONAT E MBROJTURA

Nr.	Emërtimi i dëmit	Njësia e matjes	Vlera për njësi (lekë)
1	Prerje fidanësh dhe lastarësh		
	deri 2 cm	copë	500
	2,1-10 cm	copë	3,000
2	Prerje fidanësh dhe lastarësh në masë:		
	- në pyje me diametër deri 10 cm dhe deri në 50 % të sipërfaqes	ha	500,000
	- në pyje me diametër deri 10 cm dhe në mbi 50 % të sipërfaqes	ha	750,000
	- në shkurre, deri në 50 % të sipërfaqes	ha	150,000
	- në shkurre, në mbi 50 % të sipërfaqes	ha	200,000
3	Dëmtim në çfarëdo mënyre i fidanëve, filizave e drurëve me diametër:		
	deri 2 cm	copë	350
	2,1-10 cm	copë	1,000
	10.1-22 cm	copë	3,500
	> 22 cm	copë	6,000
4	Dëmtim në masë i fidanëve në pyllëzimet artificiale dhe në fidanishte:		
	- me diametëri deri 10 cm, deri në 50 % të sipërfaqes	ha	400,000
	- me diametëri deri 10 cm, në mbi 50 % të sipërfaqes	ha	700,000
5	Prerje drurësh:		
a	Halorë:		
	I. Pishë e zezë, e detit, e butë dhe e egër:		
	10-22 cm	m ³	2,800
	> 22 cm	m ³	4,000
	II. Rrobull dhe arnen:		
	10-22 cm	m ³	3,300
	> 22 cm	m ³	4,600
	III. Bedh dhe hormoq:		
	10-22 cm	m ³	3,100
	> 22 cm	m ³	4,400
b	Fletorë:		
	I. Ah:		
	10-22 cm	m ³	2,000
	> 22 cm	m ³	3,600
	II. Dushqe:		
	10-22 cm	m ³	2,700
	> 22 cm	m ³	4,600
	III. Arrë, gështenjë, panjë, vidh	m ³	7,500
	IV. Carac, eukalipt, man, mëllezë, plep, rrap, shëlg, shkozë	m ³	3,000
	V. Bli, frashër, gështenjë e egër, mështekën, vërri	m ³	5,800
VI. Lloje të tjerë:	m ³	4,000	

6	Dëmtim nga zjarri:		
a	Kur vlerësohet materiali drusor:		
	- në pyje trungishte natyralë, artificialë dhe në fidanishte	ha	350,000
	- në pyje cungishte	ha	120,000
	- në shkurre	ha	75,000
b	Kur materiali drusor është i dëmtuar plotësisht:		
	- në pyje trungishte natyralë, artificialë dhe në fidanishte	ha	2,000,000
	- në pyje cungishte	ha	1,000,000
	- në shkurre	ha	600,000
7	Shpyllëzimi i fondit pyjor ose i pyjeve pa miratimin përkatës, pa përdorimin e tokës:		
	- në pyjet trungishte	ha	8,500,000
	- në pyjet cungishte	ha	5,000,000
	- në shkurre	ha	2,500,000
	- në pjesë të tjera të fondit pyjor	ha	1,700,000
8	Zënie ose përdorim pa leje i sipërfaqeve, pa i dëmtuar ato:	ha	3,000,000
9	Përvetësim dhe shitja pa leje:		
	- lëndë punimi	m3	70,000
	- dru zjarri	mst	35,000
	- dru zjarri ngarkese kali	barrë	11,000
	- dru zjarri ngarkese gomari	barrë	8,000
	- dru zjarri ngarkese njeriu	barrë	5,000
10	Prodhim, grumbullim dhe shitje pa leje		
a	Fruta e fara:		
	- të njoma	kg	3,000
	- të thata	kg	5,000
b	Rrëshirë pishe e katran	kg	1,500
c	Fletë dafine:		
	- të njoma	kg	3,000
	- të thata	kg	5,500
d	Bimë mjekësore e tanifere:		
	- të njoma	kg	6,000
	- të thata	kg	12,000
e	Rrënjë e kucka shqope, mare, bushi e të tjera si këto	kg	12,000
f	Thupra shelgu e lloje të tjera të kësaj natyre:		
	- të njoma	kg	1,300
	- të thata	kg	2,500
	- të zhveshura	kg	3,500
g.	Qymyr druri, eshkë kovaçi, e të tjera të kësaj natyre	copë	35,000
h	Fuçi, kade, govata druri, e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia.	copë	17,000
i	Kosha, shporta e të tjera të kësaj natyre prej thupra shelgu e lloje të tjera pyjore, pavarësisht nga madhësia	copë	12,000
11	Ndërtim pa leje i furrave të gëlqeres, kamina për qymyr druri, eshkë kovaçi, katrani e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia	copë	10,000
12	Dëmtimi ose zhdukja e objekteve të mbarështimit, gjeodezike e topografike dhe të tjera të kësaj natyre	copë	6,000
13	Dëmtimi ose zhdukja e ndërtimeve apo strehimeve për shtimin e gjahut e të tjera si këto, kudo që ndodhen	copë	12,000

14	Dëmtimi ose zhdukja e pikave dhe kullave të vrojtimit për ruajtjen e florës dhe faunës nga sëmundjet, insektet dhe zjarret	copë	10,000
15	Dëmtimi i rrethimeve në ZM	ml	6,300
16	Kryerja e gërmimeve ose punimeve të tjera për nxjerrjen e gurëve, rërës, zhavorrit, dheu, humusit, plisave të barit e të tjera si këto	m ²	8,000
17	Hapja e gropave pa leje dhe mosmbulimi i tyre	m ³	5,200
18	Shkulja e cungjeve pa leje	copë	30,000
19	Hapja pa leje e gurove dhe karrierve	m ²	50,000
20	Hapja e rrugëve, linjave telefonike, telegrafike, televizive, gazsjellëse, naftësjellës, kanaleve, linjave të tensionit të lartë, ujësjellësve e të tjera të kësaj natyre, pa miratimin përkatës	m ³	60,000
21	Kullotja pa leje:		
	- për gjedhët	krerë	3,000
	- për të leshtat	krerë	1,600
	- për të dhirtat	krerë	2,000
	- për derrat	krerë	2,500
	- për shpendët	krerë	550
	- për njëthundrakët	krerë	2,500
22	Kositja dhe grumbullimi pa leje i barit, gjetheve, krandeve e të tjera të kësaj natyre.	kv	4,000
23	Vendosja e mullarëve të çfarëdo lloji e madhësie pa leje dhe jashtë vendeve të miratuara	copë	3,000

NR.PROT. 6399/1
DATË 16-2 2020

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË ZONAVE TË
MBROJTURA
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

